# DËSHMI ARKIVI

**A-450477**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK, Bido: Një kartë e re në dorën e Serbisë kundër Kosovës - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/vendimi-i-hages-per-ish-kreret-e-uck-bido-nje-karte-e-re-ne-doren-e-serbise-kunder-kosoves/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 19:53:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 19:52:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9ed2714bc848240a39c999d5aac3ad149d3515c3344b38af4193bca38dc6e88e` |
| TEKSTI | `499626865d340f95d12f8df4941b6002ee8356fff4e9252b59ae051431a7ab5c` |
| PAMJA | `be299e02811a9cb295ce380c3003b428849a1c4a0fa828810eaabb1e2b4f73a7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `859b89c723e04d1cb5171be20ff8d4186c007452a91bacd27145d95f73c3b0a9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f72115bb0c326093347f412235a8c378aab409f85fb276171d0e9653b9a6bcbd` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/859b89c723e04d1cb5171be20ff8d4186c007452a91bacd27145d95f73c3b0a9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

NOW ME ERLA MËHILLIN

# Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK, Bido: Një kartë e re në dorën e Serbisë kundër Kosovës

16 Shtator 2026 | 21:52

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Deputeti i Partisë Socialiste, Ardit Bido, komentoi në emisionin “Now” në Euronews Albania vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë për dënimin me 81 vite burg në total të katër ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Sipas Bidos, vendimi i Gjykatës Speciale, përtej asaj që ai e cilësoi si “absurditet”, ka pasoja të drejtpërdrejta politike për shqiptarët dhe Kosovën në marrëdhëniet ndërkombëtare.

“Është një vendim që, përtej absurditetit të tij, është një vendim me pasoja të drejtpërdrejta politike sa i përket peshës specifike të faktorit shqiptar dhe të Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare”, u shpreh Bido.

Sipas tij, pavarësisht se gjykata është kujdesur të theksojë se nuk bëhet fjalë për UÇK-në si organizatë, personat e dënuar kanë qenë drejtues të saj.

“Pavarësisht se u kujdes gjykatësi të thoshte se nuk është UÇK-ja, grup i strukturuar kriminal, janë krerët e UÇK-së. Për të cilët flisnin, ishin drejtuesit e UÇK-së, që nuk janë grup i strukturuar kriminal, por grup i strukturuar çlirimtar”, tha Bido.

Bido foli edhe për ndikimin që, sipas tij, vendimi mund të ketë në pozicionin ndërkombëtar të Kosovës. Ai përmendi në këtë kontekst edhe presidentin serb Aleksandar Vuçiç dhe marrëdhëniet e Serbisë me Kosovën.

“Fakti që Vuçiç po flet me tone të ulëta dhe gati si humbës i kësaj beteje tregon qartë se ka tashmë edhe një kartë tjetër në dorë për ta bërë më të vështirë rrugën e Kosovës drejt BE-së, OKB-së apo shmangies së çdo ndërhyrjeje tjetër serbe në Kosovë”, deklaroi ai.

**Shiko në:**

## LAJMI I FUNDIT

21:23 **Rutte: NATO përballet me sfidat më të mëdha të sigurisë**

21:22 **Amnesty International: Dënimet ndaj Thaçit dhe të tjerëve tregojnë se zyrtarët e lartë nuk janë mbi ligjin**

21:17 **Gjermania bën thirrje që të respektohet vendimi i Speciales**

21:15 **Katër kopje të librit të ri për Princeshë Dianën vidhen në Holandë**

21:10 **HRW për vendimin e Speciales: Moment i rëndësishëm për viktimat që pritën për drejtësi**

21:02 **Ministri Hoti flet për Euronews nga Haga: Drejtësia ndërkombëtare shpërbleu agresorin dhe dënoi viktimat**




## LAJME TË SUGJERUARA

LAJM KRYESOR | NOW ME ERLA MËHILLIN

### Çfarë pritet të ndodhë në Hagë? Ish-ambasadori: Jam i shqetësuar, janë shpenzuar 500 mln euro për...

Ish-ambasadori i Shqipërisë në SHBA, Roland Bimo, ka komentuar zhvillimet në prag të vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për ish-krerët e UÇK-së. I ftuar...

22:34 | 15/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

### "Zjarret e lirisë" ndizen në Prishtinë, qytetarët presin verdiktin për ish-krerët e UÇK-së

Gazetari i Euronews në Kosovë, Xhemajl Rexha, raportoi për emisionin "Now me Erla Mëhillin" nga sheshi "Skënderbej" në qendër të Prishtinës, 12 orë para vendimit...

22:30 | 15/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

### "U bë gjysh katër herë", djali i Jakup Krasniqit flet nga Haga: Nesër presim pafajësi

Në një lidhje nga Haga për emisionin "Now me Erla Mëhillin", gazetarja e Euronews, Esmeralda Mualaj, mori një intervistë me djalin e Jakup Krasniqit, Altin...

21:54 | 15/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.